

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët Shqipe Qerimi Kryetare, Rasim Rasimi dhe Gani Zabeli, anëtarë me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Visar Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.D. nga Prishtina, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 185 par.2 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit av. L.J., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.220/2017 të datës 20.03.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 10.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit A.D., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.220/2017 të datës 20.03.2017, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin P.nr.220/2017 të datës 20.03.2017, të akuzuarin A.D., e ka shpallur fajtor, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 185 par.2 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënimin me kusht, duke ia vërtetuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1(një) viti nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale. Në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.24.01.2017 deri me dt.15.02.2017.

Palën e dëmtuar e ka udhëzuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt civil.

Të akuzuarin gjykata e ka obliguar që ti paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 25€, në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :

Mbrojtësja e të akuzuarit av. L.J., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga dënimi.

Prokurori i Apelit me parashtrësën PPA/II.nr.1000/2017, të datës 11.09.2017, ka propozuar që ankesa e mbrojtëses të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet në ankesë në ankesë gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale në ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit theksohet se aktgjykimi i ankimuar është marr me shkelje esenciale, konkretisht duke u bazuar në komentarin e kodit penale të Kosovës neni 185 par.1 pika 3 pasi që thekson se nëse një person e njofton tjetrin përmes personit të tret se do ta gjej një e keqe, atëherë konsiderohet se nuk është kryer vepra penale Kanosje, por është kryer vetëm vërejtja, e që në rastin konkret ka ndodhur e njëjta. Sipas vlerësimit të të kolegjit të gjykatës së Apelit i pabazuar është qëndrimi ankimor i mbrojtëses së të akuzuarit , sepse nuk mund të konsiderohet se është kryer vetëm vërejtja, sepse në rastin konkret kërcënimi nuk është bërë përmes personit të tretë por kërcënimi është bërë direkt nga i akuzuari përmes telefonit të V.D. , i cili i është kërcënuar se veç sa ta takoj Agonin djalin e H.D. “ se nuk e la pa e vra”. Pra në rastin konkret përmbushen të gjitha elementet e veprës penale të kanosjes nga neni 185 par 1 pika 3 të KPRK-së. Kjo veprë penale sipas dispozitës së nenit të lartcekur kryhet në rastet kur ndokush i kanoset seriozisht personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ti shkaktojë ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose shkakimit të ankthit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit pretendimet e mësipërme ankimore, përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara e as që ka shkelje të tjera të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare, e të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij. Aktgjykimi i ankimuar është i qartë, nuk përmban kundërthënie qoftë me vetveten ose me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë . Gjykata e shkallës së parë, i vënë në dukje se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merre si të provuara ose si të paprovuara dhe njëkohësisht ka bërë vlerësimin e provave kontradiktore.

Me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, edhe Ligji penal është aplikuar në mënyrë të drejtë, me rastin e shqiptimit të dënimit.

Sa i përket vendimit për dënim në ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit pretendohet se dënimi i shqiptuar nuk është në përpjesëtim me mundësitë të cilat ligji ia ka lënë trupit gjykues, që ti vlerësoj të gjitha rrethanat e parapara ligjore.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimi i mbrojtëses së të akuzuarit për një dënim më të butë është i pabazuar. Gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit siç parashihet në dispozitën e nenit 73 të KPK. Kështu, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin mori për se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, se është mbajtës i familjes, andaj të akuzuarit konform nenit 50 dhe 51 të KPRK-së i shqiptoi dënimin me kusht.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dënimi që iu është shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në përpjesëtim me intensitetin e rrezikshmërisë

shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet ti shërbejë preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryesi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhëm, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikojë në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, konsideron se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK- , ku do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga kjo që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr. 983/17, me dt. 10.10.2017

Zyrtari Ligjor
 Visar Gashi

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

1. Rasim Rasimi

Shqipe Qerimi

2. Gani Zabeli